

# Llojet e shpenzimeve dhe fitimit

## Kontabilitet

Përmes blerjes, prodhimit dhe shitjes së të mirave dhe shërbimeve gjatë një periudhe të dhënë kohore shkaktohen shpenzime dhe fitime.

Shpenzimet	Fitimi
<p>Për përgatitjen e punëve ndërmarrëse do të:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>● Përdoren materiale</li><li>● Krijohen të mira</li><li>● Futen fuqi punëtore</li><li>● Kërkohen shërbimet e të tjerëve (p.sh. qeraja)</li><li>● Nevojitet mjete (p.sh. makina, automjete etj.)</li></ul> <p>Këto:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>● shkaktojnë shpenzime materiale</li><li>● vendosin për blerje të mirave</li><li>● shkaktojnë pagesa të pagave</li><li>● kërkojnë pagesa të qirave</li><li>● shkaktojnë konsumim (amortizim) të objekteve dhe gjesendeve (makina, veglave, automjeteve etj.)</li></ul>	<p>Gjatë sjelljes së shërbimeve ndërmarrëse do të:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>● Shiten të mira</li><li>● Shiten produkte</li><li>● Sillen shërbime</li></ul> <p>Këto:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>● japin të ardhura nga shitja e të mirave</li><li>● sjellin fitim nga produktet e shitura</li><li>● qojnë deri tek të ardhurat përmes shërbimeve të kryera</li></ul>

Këto përdorime të të mirave në kontabilitet njihen si shpenzime (p.sh. shpenzimet materiale, shpenzimet e pagave, shpenzimet e qerasë, amortizimet etj.)

Këto rritje të vlerave në kontabilitet njihen si fitim (p.sh. fitimi nga të mirat, nga prodhimi, nga shërbimet etj.)

Llojet kryesore të shpenzimeve dhe fitimeve janë si vijon:

Shpenzimet kryesore	Emërimi
- blerja e të mirave tregtare të cilat shiten metutje pa u ndryshuar	Shpenzim për të mirat (blerje e të mirave)
- blerja e lëndës së parë për përpunim/prodhim	Shpenzim për lëndë të parë (blerje e lëndës së parë)
- shpenzimet për pagat e personelit dhe rrogat, shërbimet sociale etj.	Shpenzimet për personel
- shpenzimet për shfrytëzimin e gjërave apo objekteve të të tjerëve.	Shpenzimet e qerasë
- mirëmbajtja, reparimi, leasing	Shpenzimet për mirëmbajtje dhe reparime
- humbjet, amortizimi për debitor	Humbje debitor (nga borxhlinjtë)
- rryma, gazi, ngrohja, uji	Shpenzimet energjetike
- premiat për sigurimin	Shpenzimet e sigurimit

- reparimi, benzina, përkujdesja etj, për automjete	Shpenzimet për automjete
- inserate, reklama, dhurata, konsultime etj	Shpenzimet e marketingut
- letra, marteriali për zyrë, shtypja, telefoni, pullat postare etj.	Shpenzimet në zyrë
- ulja e vlerës se gjesedeve si pasojë e shfrytëzimit dhe vjetërimit teknik	Amortizimet
- konto e përgjithshme për shpenzime te ndryshme ndërmarrëse	Shpenzimet tjera

<b>Fitimet kryesore</b>	<b>Emërimi</b>
- shitja e te mirave tregtare	Fitimi nga te mirat (shitja e te mirave)
- shitja e produkteve te prodhuara vetë	Fitimi nga prodhimi
- dëmshpërblim për shitjen e shërbimeve	Fitimi nga honorari (nga shërbimi)
- te ardhurat nga qiradhënja e objekteve vetanake	Fitimi nga imobiliet (qeraja)
- dividenta në akcione	Fitimi nga letrat me vlerë
- konto e përgjithshme për fitime te ndryshme	Fitime tjera

Migrosschule  
Përkthej: Xh. Muslija